Pa. nr. 08-135/2026

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar lidhur me njoftimin për përqendrim të parashtruar nga Sinidia Solutions, me seli të regjistruar në 5 Rue Thiers, 68100 Mulhouse, Francë, të dorëzuar nëpërmjet Shoqërisë së Avokatëve Qoku dhe Partnerët nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 14.10.2026, miratoi këtë:

AKTVENDIM

1**.** Konstatohet se përqendrimi, me të cilin Sinidia Solutions, me seli të regjistruar në 5 Rue Thiers, 68100 Mulhouse, Francë, ka për qëllim të fitojë kontroll të vetëm mbi Shoqërinë për Shërbime BILIVIO SHPK Shkup, me seli të regjistruar në rr. Fjodor Dostojevski nr. 72, Shkup – Karposh, Republika e Maqedonisë së Veriut, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve në treg, dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumën prej 6.000,00 denarësh dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarësh, sipas tarifës nr. 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të hyrave dhe programi 72231300.

3. Padia për inicimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), më datë 14.09.2026, ndërsa i plotësuar më datë 23.09.2026 dhe më datë 28.09.2026, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejmë: Komisioni) iu dorëzua njoftimi për përqendrim nga ana e Sinidia Solutions, me seli të regjistruar në 5 Rue Thiers, 68100 Mulhouse, Francë, me të cilin Sinidia Solutions synon të fitojë kontroll të vetëm mbi Shoqërinë për Shërbime BILIVIO SHPK Shkup, me seli të regjistruar në rr. Fjodor Dostojevski nr. 72, Shkup – Karposh, Republika e Maqedonisë së Veriut, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit që nga dita e pranimit të tij dhe, në bazë të të dhënave të paraqitura në Njoftimin për Përqendrim, plotësimit të tij dhe dokumenteve bashkëngjitur, konstatoi sa vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Sinidia Solutions është shoqëri e varur e Grupit Apave, e specializuar në zhvillimin e softuerit për menaxhimin e aseteve të ndërmarrjeve (Enterprise Asset Management – EAM), i cili u mundëson përdoruesve të menaxhojnë më mirë rreziqet dhe pajisjet.

Sinidia Solutions është pjesë e njësisë më të gjerë afariste Sinidia të Grupit Apave, e specializuar në zhvillimin dhe shitjen e zgjidhjeve softuerike. Oferta e Sinidia është e strukturuar rreth dy shtyllave:

- Softueri EAM i Sinidia Solutions; dhe
- Sinidia Digital: njësi afariste që zhvillon zgjidhje tërësisht të përshtatura sipas nevojave të klientëve, të cilat mund të avancohen me inteligjencë artificiale.

Grupi Apave është një grup ndërkombëtar me histori prej gati 160 vjetësh, i specializuar në menaxhimin e rreziqeve teknike, njerëzore, mjedisore, digjitale dhe klimatike.

Grupi Apave aktualisht ka 18.500 të punësuar, 130 subjekte të lidhura në Francë, 170 qendra trajnimi në Francë dhe jashtë saj, si dhe më shumë se 20 qendra për testimin dhe certifikimin e pajisjeve.

Grupi Apave ka prani ndërkombëtare në afro 60 shtete. Nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të inspektimit dhe testimit jodestruktiv (NDT), certifikimit, trajnimit teknik, testimit dhe matjeve, si dhe shërbimeve të konsulencës, Grupi Apave mbështet kompanitë private dhe organet publike në Francë dhe në nivel ndërkombëtar.

Grupi Apave aktualisht ushtron kontroll të përbashkët mbi BILIVIO SHPK Shkup nëpërmjet shoqërisë së tij të varur, në pronësi të plotë të tij, e cila zotëron 51% të pjesëve të kapitalit në BILIVIO SHPK Shkup.

Përveç pjesëmarrjes së tij në BILIVIO SHPK Shkup, Grupi Apave ka edhe shoqëritë e mëposhtme të varura të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut:

- Shoqëria për Kontroll Teknik, Analiza, Qarkullim dhe Shërbime APAVE SEE SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rr. Fjodor Dostojevski nr. 72, Shkup – Karposh, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe me veprimtari prioritare të regjistruar 71.200 – Kontrolli teknik dhe analiza;
- Shoqëria për Inxhinieri, Këshillim Teknik, Qarkullim dhe Shërbime NOLTEN SERVICES SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rr. Fjodor Dostojevski nr. 72, Shkup – Karposh, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe me veprimtari prioritare të regjistruar 71.120 – Veprimtari inxhinierike dhe këshillim teknik i ndërlidhur;
- Shoqëria për Kontroll Teknik, Analiza, Qarkullim dhe Shërbime APAVE ROPE ACCESS SHPK Shkup, me seli të regjistruar në rr. Fjodor Dostojevski nr. 72, Shkup – Karposh, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe me veprimtari prioritare të regjistruar 71.200 – Kontrolli teknik dhe analiza;
- Shoqëria për Inxhinieri, Këshillim Teknik, Qarkullim dhe Shërbime ETBS SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rr. Fjodor Dostojevski nr. 72, Shkup – Karposh, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe me veprimtari prioritare të regjistruar 71.120 – Veprimtari inxhinierike dhe këshillim teknik i ndërlidhur;

- Shoqëria për Kontroll Teknik, Analiza, Qarkullim dhe Shërbime AAIA-BPV SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rr. Fjodor Dostojevski nr. 72, Shkup – Karposh, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe me veprimtari prioritare të regjistruar 71.200 – Kontrolli teknik dhe analiza.

Këto shoqëri janë të specializuara në menaxhimin e rreziqeve teknike, sigurinë, sigurimin e cilësisë, inxhinierinë dhe shërbimet përkatëse të këshillimit teknik. Aktivitetet e tyre afariste përfshijnë inspektime industriale rregullatore dhe jorregullatore, testime jodestruktive (NDT), vlerësime teknike, analiza, certifikimin e sistemeve të menaxhimit dhe këshillim inxhinierik. Përveç kësaj, ato ofrojnë një gamë të gjerë programesh profesionale të trajnimit në fushën e shëndetit, sigurisë dhe mjedisit jetësor, si dhe certifikime teknike të specializuara.

BILIVIO SHPK Shkup është një shoqëri softuerike franko-maqedonase, e cila ushtron veprimtarinë e saj në Republikën e Maqedonisë së Veriut që nga viti 2018 dhe ka të regjistruar veprimtarinë prioritare: 62.100 – Programimi kompjuterik. BILIVIO SHPK Shkup ka përvojë të dëshmuar në zhvillimin e zgjidhjeve softuerike për ndërmarrje, me një bazë klientësh të përbërë ekskluzivisht nga shoqëri në kuadër të Grupit Apave.

BILIVIO SHPK Shkup nuk ka shoqëri të varura të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose jashtë saj, ndërsa të gjitha të ardhurat e saj realizohen nga Grupi Apave.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, pasi i përmbush kushtet e nenit 12 paragrafi (1) dhe të nenit 14 paragrafi (1), pikat 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafët (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat, gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, megjithëse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1), pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative, brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE
Mr. Малинка Силјановска Николиќ